



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1288/2 Prot.

Tiranë, më 23.09.2021

V E N D I M

Nr. 182, Datë 23.09.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 164, datë 14.09.2021, të paraqitur nga F.K, kundër Shkollës “Atë Pjetër Meshkalla” dhe Zyrës Vendore Arsimore Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për çdo shkak tjetër¹.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Vajza e saj K.K.M ka lindur në Kanada në vitin 2003 dhe në certifikatën e lindjes nuk është shënuar emri i babait sepse nuk ka qenë i pranishëm në lindje, dhe ligji Kanadez e lejon këtë gjë. Më pas është kthyer në Shqipëri dhe atësia ka mbetur ashtu siç ka qenë e plotësuar në certifikatën e lindjes (information not). Vajza ka ndjekur shkollën në Shqipëri që nga klasa e dytë dhe ka vazhduar gjimnazin në shkollën “Atë Pjetër Meshkalla” në Shkodër. Që në momentin e konkursit në këtë shkollë, vajza e saj është paragjykuar, pasi në listat e nxënësve është shkruar: (emri) K.K, (atësia) ska, (mbiemri) M. Pas ankimit tek drejtori i shkollës, atësia u ndërrua, duke u shënuar (nuk ekziston) dhe vajza ka vazhduar studimet deri në vitin 2021. Në moshën 16 vjeçare vajza është pajisur me kartë identiteti: (emri) K.K dhe (mbiemri) M. Shkolla “Atë Pjetër Meshkalla” në

¹ Ankuesja nuk ka deklaruar emrin e babait të vajzës, kur ka regjistruar fëmijën e lindur në Kanada.

diplomën e përfundimit të shkollës së mesme ka plotësuar: (emri) K.K, (atësia) Nuk rezulton, (mbiemri) M, veprim i cili është diskriminues që i bëhet asaj si nënë dhe vajzës së saj për faktin se nuk e ka shënuar emrin e babait në certifikatën e lindjes dhe shkolla paragjykon atë dhe vajzën duke e cilësuar si pa baba, vetëm për faktin që nuk i është shënuar emri në certifikatën e lindjes. Vajza është përballur me këtë problem dhe është ndier e fyer dhe e paragjykuar në mesin e nxënësve të tjerë. Në ditën e provimit/eve të Maturës Shtetërore vajza është thirrur në mesin e të gjithë maturantëve, duke i thënë, ç'është ky emër kështu, duke e paragjykuar në prezencë të bashkëmoshatarëve të saj, gjë e cila ka ndikuar në gjendjen emocionale të saj. Gjithashtu, duke qenë se në të njëjtën shkollë vazhdon mësimet dhe vajza tjetër, e cila nuk e ka këtë problem, pasi e ka të shënuar emrin e babait dhe mësueset e kanë pyetur disa herë “nuk keni të njëjtin baba”. Në përfundim të provimeve ka dalë Diploma e Maturës Shtetërore, e cila ishte plotësuar: (emri) K.K, (atësia) Nuk rezulton, (mbiemri) M. Ajo si prind është ankuar dhe përpara daljes së diplomës tek shkolla dhe në zyrën arsimore, por nuk ka marrë një shpjegim të arsyeshëm. Ankuesja pretendon se vajza e saj po diskriminohet për shkak se nuk ka të shënuar emrin e babait në certifikatën e lindjes, dhe nuk shpjegon dot se si mund të shkruhet në diplomë emri i babait “nuk rezulton”, gjë e cila mund të bëhet pengesë nesër, për tu regjistruar në universitet dhe do ta përndjekë gjithë jetën”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e atësisë në diplomë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7/1 i LMD-së², parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirisë

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Duke qenë se shpjegimet dhe dokumentacionet e dhëna nga ankuesi ishin të paplota, inspektori i çështjes, bazuar në kërkesat e nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me e-mail-in datë 17.09.2021, kërkoi nga ankuesi plotësimin e ankesës me shpjegime dhe dokumentacion.

Në vijim, ankuesi me e-mail-in datë 20.09.2021, të dërguar në adresë të inspektorit të çështjes, ka kërkuar të tërheqë ankesën, pasi do të vazhdojë me aplikimin drejt shtetit të Kanadasë me shpresën se do të rregullojë problemin e saj atje.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga F.K, e cila me anë të kërkesës, datë 20.09.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 164, datë 14.09.2021, paraqitur nga F.K kundër Shkollës “Atë Pjetër Meshkalla” dhe Zyrës Vendore Arsimore Shkodër, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA